

KRONIKË E ZEZË

Në Ferizaj e Gjakovë vidhen dy pistoleta, fishekë, ar dhe para



31 tetor 2022, 09:40

Në 24 orët e fundit, në Ferizaj e Gjakovë, janë shënuar dy vjedhje "të pazakonta".

Policia në raportin e së hënës, ka njoftuar se hajnat në këto qytete janë futur në dy shtëpi dhe kanë vjedhur pistoletë e fishekë.

Në Ferizaj, pos pistoletës e 100 fishekëve është vjedhur edhe stoli i arit, kurse në Gjakovë edhe një shumë parash.

Policia nuk ka dhënë detaje nëse armët e vjedhura ishin me leje.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

#PISTOLETE

#VJEDHJE

TË TJERA

